



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PEQIN  
NJËSIA E PROKURIMIT

Peqin, më 11/05/2026

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje Karburanti”;

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Karburant

Diesel: 09134100-8

Benzinë: 09132000-3

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 8,400,000 (tetedhete e katermiljon ) Lekë pa TVSH nga buxheti i Bashkisë Peqin për nevoja të Bashkisë Peqin, për vitin 2026;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Peqin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4,

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### Kapacitetin profesional/ligjor të operatorëve ekonomikë:

a. Të plotësoj kriteret e përgjithshme sipas shtojces 8. Objekti i prokurimit të jetë i parashikuar në ekstraktin e operatorit ekonomik. Të paraqitet leja përkatëse për lejimin e tregtimit të karburanteve sipas objektit të prokurimit.

**2.1.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilesise se shërbimit **ISO 9001- 2015 OSE EKUIVALENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

**2.1.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën e **ISO 14001:2015 OSE EKUIVALENTE** me te, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit. *vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e Certifikatave.

**Argumentimi:** *Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njohura me origjinalin (kopje të noterizuar). Certifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet kur oferta dorëzohet nga një BO, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kërkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025. Vërtetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** të procedurës së prokurimit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël por pa tejkaluar vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, të kontratës që prokurimet

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohej për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, \ëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. Shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifave vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimit për taksat dhe tarifave vendore).

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të*

*dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit që prokurohet .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur të thjeshtuar është përcaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 5 (pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit; Konkretisht për këto pike operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 5 (pesë) punonjës për periudhën Dhjetor 2023-Janar-Shkurt 2024 të vertetuar me :

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Dhjetor 2025-Janar-Shkurt 2026

- Listepagesat E-Sig 025 për periudhën Dhjetor 2025-Janar-Shkurt 2026, të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, etj.

*Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa për minimumi 5 punonjës është vendosur për të garantuar se operatori ekonomik disponon burimet njerëzore të nevojshme për menaxhimin e një kontrate furnizimi me karburant për një institucion publik.

Ky numër justifikohet nga nevoja për:

- administrim të pikave të shitjes;
- menaxhim të kartave elektronike dhe raportimeve mujore;
- personel për furnizim fizik me autobot;
- staf financiar dhe faturim;
- personel rezervë për mbulim turnesh dhe raste emergjente.

Karburanti është mall strategjik për funksionimin e mjeteve të bashkisë, shërbimeve emergjente, transportit administrativ dhe ngrohjes së objekteve publike. Për këtë arsye kërkohet operator me strukturë funksionale reale dhe jo subjekt formal pa kapacitete njerëzore.

**2.3.3** Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesive përgjatë vitit të fundit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqese Vërtetim teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK, Leje mjedisore të tipit B, të leshuar nga QKL, Akt-Teknik të leshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi të leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri për distributorët e shitjeve me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë së datës së hapjes së ofertave) për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë ekonomikë të dëshmojnë me dokumenta konkrete për përmbushjen e këtyre kriterëve.

**2.3.5** Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasitë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktore. Kartë elektronike duhet të jenë pa afat skadencë deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartëve elektronike të personalizuar, sipas adresave të kerkuara nga Autoriteti Kontraktor. Furnizimi me karburant për kaldajat e objekteve arsimore duhet të kryhet me anë të tollonave.

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të deklarojë me shkrim se garanton dhe merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant në të paktën 1 stacion/pikë të tregtimit/shitjes së karburantit me pakicë në territorin e bashkisë Peqin, ku ka vendndodhjen autoriteti kontraktor në pronësi ose me qera, të cilat do të shërbejnë për furnizimin e automjeteve të AK. Kjo kërkesë duhet të vërtetohet me një nga format e përcaktuara në Kodin Civil (kontratë qeraje ose akt pronësie). Në deklaratë duhet të përcaktohet qartë vendndodhja e pikave të karburantit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).*

**Furnizim me karta elektronike :**Ky kriter synon kontrollin financiar, gjurmueshmërinë e konsumit dhe eliminimin e abuzimeve. Karta e lidhur me targën e mjetit mundëson:

- identifikim të mjetit përfitues;
- kontroll sasior në kohë reale;
- raportim periodik;
- shmangie të përdorimit të paautorizuar.

### **Konvertimi i litrave të mbetur në furnizim me autobot**

Kjo kërkesë mbron interesin ekonomik të autoritetit kontraktor duke garantuar se çdo sasi e parapaguar ose e disponueshme do të përdoret deri në fund të kontratës dhe nuk humbet.

### **Furnizim për kaldajat dhe mjetet e shërbimeve publike me tollona ose mënyrë të dedikuar**

Objektet arsimore kanë nevojë për furnizim të organizuar dhe të kontrolluar për ngrohje sezonale. Kjo kërkesë garanton vazhdimësinë e shërbimit publik në shkolla dhe kopshte. Si dhe për mjetet e shërbimeve publike të Bashkisë së Peqin .

**2.3.7** Të gjitha stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me dokumentacion si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakice;
- Certificate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Flete analiza të lëshuar nga ISHTI e cila duhet të jetë lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter garanton që çdo pikë furnizimi është:

- e licencuar ligjërisht;
- e sigurt nga aspekti kundër zjarrit;
- me cilësi të kontrolluar të karburantit;
- e aftë për operim normal dhe publik.

Fletë-analiza e fundit laboratorike brenda afatit të përcaktuar siguron që cilësia e karburantit është aktuale dhe jo e vjetëruar. Kjo është shumë e rëndësishme pasi cilësia e karburantit mund të ndryshojë nga kushtet e ruajtjes.

Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem**“, Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një

Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR BENZINË ( premium 10ppm )**

Specifikimet teknike për benzinë (premium 10 ppm) duhet të jenë sipas **standartit S SH EN 228**, si me poshtë:

Nr.	Treguesi çilesor	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Minimale	Maksimale
1	Numri i oktanit kërkimor NOK		95,0	-
2	Numri i oktanit motorik NOM		85,0	-
3	Përmbajtja e Plumbit	mg/l	-	5,0
4	Densiteti ( në 15 0 C )	kg/m <sup>3</sup>	720,0	775,0
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
6	Përmbajtja e magnezit	mg/l	-	6,0 2,0
7	Stabiliteti ndaj oksidimit	minuta	360	-
8	Përmbajtja e rreshirave faktike ( të lara në tretës )	mg/100ml	-	5
9	Korrozioni i shufrës së bakrit ( 3 orë ne 50 0 C )	renditje	Klasa 1	
10	Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
11	Permbajtja e tipit te hidrokarburit -Olefinat -Aromatiket	% (V/V )	- -	18,0 35,0
12	Permbajtja e benzenit	% (V/V )	-	1,00
13	Përmbajtja e oksigjenit	% ( m/m )	-	2,7
14	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore - Methanol ( alkol metilik ) - Etanol ( alkol etilik)	% (V/V)	- -	3,0 5,0

15	-alkol iso- propilik -alkol iso – butilik - alkol terc – butil - etere ( me 5 ose më shumë atome C ) h	mg/l	- -	Përzierja ne vëllim i kufizuar ne 2,7 % ( m/m ) te O2
----	---	------	--------	---

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR GAZOIL 10 ppm**

Specifikimet teknike për gazoil 10 ppm, duhet të jenë sipas **standartit S SH EN 590**, si më poshtë:

Nr.	Treguesi cilesor	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Minimale	Maksimale
1	Numri i cetanit		51,0	-
2	Indeksi i cetanit		46.0	-
3	Densiteti në 15 C	kg/m <sup>3</sup>	820,0	845,0
4	Hidrokarburet aromatike policiklike	%(m/m)	-	10,0
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
6	Pika e flakërimet	oC	Mbi 55	-
7	Përmbajtja e koksit ( në 10% mbetje distilim )	%(m/m)	-	0.30
8	Përmbajtja e hirit	%(m/m)	-	0.010
9	Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200
10	Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer )( wsd 1,4 ) në 60 0 C	um	-	24
11	Korrozioni i shufrës së bakerit ( 3 orë në 50 oC)	Klasifikim	Klasa 1	
12	Stabiliteti i oksidimit	g/m <sup>3</sup> h	- 20	25 -
13	Viskoziteti në 40 oC	mm <sup>2</sup> /s	2.000	4.500
14	Destilimi %(V/N) në 250 oC në 350 oC në 95%(V/N)	%(V/N) o C	85	<65 360
15	Përmbajtja e magnezit	mg/l	- -	6,0 2,0
16	Ndotja e përgjthshme	mg / kg	-	24
17	Përmbajtja e Esteret metilike të acideve yndynore EMAY	%(V/V)	-	7,0

**KUJDES !**Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Njësia e Prokurimit njëkohësisht Komision për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, për përcaktimin e specifikimeve teknike, etj;**